

**Rregulla e Plotësuar XIV mbi
Licencimin dhe Mbikëqyrjen e Institucioneve Mikro-Financiare
Autorizuar sipas Nenit 3, 6, dhe 7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/21**

1. Kushtet paraprake për Licencimin e Institucioneve Mikro-Financiare

Raportet financiare të dhëna në Paragrafin 7.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/28 janë të fiksuara në vijim:

- Portofolio në rrezik >30 ditë/Portofolio mesatare bruto: maksimumi 5%;
- Huat e ri negociuara (ri-programuara / ri-financuara / Kreditë totale: maksimumi 5%;
- Shpenzimet e provizionit për humbje nga huat/ Mesatarja e Portfoliosë bruto: maksimumi 5%;

2. Shuma maksimale e huave mikro-financiare nga Institucionet e Licencuara Mikro-Financiare

Shumat maksimale e kredive të ofruara për bizneset shtëpiake dhe individët më të ardhura të ulëta, si dhe për ndërmarrjet e vogla janë të fiksuara në vijim:

- 5,000 Euro për kredinë fillestare të bizneseve shtëpiake dhe individët më të ardhura të ulëta, në maksimum deri në 15,000 Euro për kreditë e përsëritura;
- 15,000 Euro për kredinë fillestare për ndërmarrjet e vogla, deri në maksimum prej 75,000 Euro për kreditë e përsëritura.

Maksimumi i shumës së rrumbullakuar së kredisë së papaguar për benefit të ndonjë grupi të lidhur, individët nuk duhet të kalojnë shumën prej 30,000 Euro. Maksimumi i shumës së rrumbullakuar i kredisë së papaguar për benefit të grupit të biznesit të lidhur nuk mund të tejkalojë shumat prej 100,000 Euro.

Drejtorët dhe menaxhmenti i lartë i institucionit mikro-financiar nuk janë të lejuar që të huazojnë nga institucioni. Punonjësit e institucioneve mikro-financiare, duke i përfshirë individët e lidhur, nuk kanë të drejtë të huazojnë për shumat që tejkalojnë limitin e kredive të cilat janë të dedikuara individëve privat. Lejimi i këtyre kredive duhet të jetë në pajtueshmëri me politikën kreditore për stafin e institucioneve mikro-financiare, dhe duhet të jenë plotësisht të aprovuara nga Bordi Drejtues.

3. Kapitali Minimal

Shuma minimale e kapitalit të paguar dhe rezervave ose ekuiteti i cili duhet të mirëmbahet nga institucionet mikro-financiare që aplikojnë për licencë, dhe shuma e cila

duhet të mbahet gjithmonë nga institucionet e licencuara mikro-financiare, duhet të jetë 2,500,000 Euro.

Kapitali i paguar dhe rezervat ose ekuiteti përfshinë:

- a) Aksionet e zakonshme dhe teprica e tyre;
- b) Rezervat e parapara me ligj, rezervat e përgjithshme, dhe fitimet neto të cilat nuk janë shpërndarë, siç janë fitimet e ruajtura;
- c) Nëse janë të regjistruara në ekuitet e jo në të ardhura: donacionet, trashëgimet,, ndihmat, dhuratat si dhe ndihmat tjera financiare, pa ndonjë nën për kthimin e parave ose obligimit të ripagesës së çfarëdo lloji;
- d) Kapitali i ekuivalencës së depozitit, nëse institucioni mikro-financiar është filial i ndonjë institucioni mikro-financiar i licencuar në ndonjë vend tjetër.

4. Ekuiteti dhe Obligimet

Kapitali i kushtëzuar i dhënë si donacion është donacion i cili nuk do të paguhet gjersa të përmbushen kushtet brenda periudhës së duhur kohore. Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës (AQBK) do të njohë kapitalin e kushtëzuar si donacion vetëm pasi që siguruesi i grantit ka dëshmuar se kushtet janë përmbushur.

5. Rregullat Bankare

Rregullat e mëposhtme bankare zbatohen, *mutatis mutandis* (me ndryshime të domosdoshme), për të gjitha institucionet mikro-financiare:

- Rregulla IX për klasifikim dhe provizionimin e mjeteve;
- Rregulla e X për shpëlarjen e parave;
- Rregulla e XII për ruajtjen e shënimeve;
- Rregulla e XV për versionin e përkthyer të rregullave dhe qëllimeve ligjore;
- Rregulla e XXVI për shpалosjen e interesit dhe publikimeve të normës së interesit;
- Rregulla e XXVIII për raportimin e kredive.

Rregullat e mëposhtme bankare zbatohen, *mutatis mutandis* (me ndryshime të domosdoshme), për të gjitha institucionet e licencuara mikro-financiare:

- Rregulla e XI për raportimin e bankave;
- Rregulla e XVI për minimumin e kërkuar të rezervës së likuiditetit;
- Rregulla e XXII për ndryshimet në llogaritë e ekuitetit të bankës;
- Rregulla e XXIV për publikimin e bilancit të gjendjes tre mujore;
- Rregulla e XXV për themelimin, zhvendosjen dhe mbylljen e filialeve; dhe
- Rregulla e XXVII për pajisjet minimale të sigurisë dhe procedurat.

6. Rregullat e Përkohshme

Institucionet e reja të licencuara mikro-financiare duhet që të ndërmarrin masa që të pajtohen me kërkesat e kësaj rregulle nëse është e mundur në kohë sa më të shkurtër, për çdo rast, jo më vonë se gjashtë muaj pas lëshimit të licencës.

7. Data e hyrjes në fuqi

Bordi Drejtues i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës e miratoi Rregullën e XIV me 7 Shkurt 2007. Kjo rregull hyn në fuqi më 29 Maj 2008. Lëshimet e mëparshme të kësaj rregulle në këtë mënyrë shfuqizohen.

Hashim Rexhepi
Drejtor i Përgjithshëm